



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Beni Construction” Sh.P.K. të datës 15.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 10.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi i Platos në lagjen Dardania, rruga Bill Klinton tek Santea” me nr. të prokurimit 616-24-3024-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Beni Construction” Sh.P.K. e datës 15.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 10.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi i Platos në lagjen Dardania, rruga Bill Klinton tek Santea” me nr. të prokurimit 616-24-3024-5-1-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 10.05.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Beni Construction” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Beni Construction” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 15.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 10.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi i Platos në lagjen Dardania, rruga Bill Klinton tek Santea” me nr. të prokurimit 616-24-3024-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

**Pretendimi i parë:** *“Arsyeja e parë e eliminimit nuk qëndron për arsye se ne kemi dorëzuar garancionin e prodhuesit për 30 vite, planin dinamik të nënshkruar dhe të vulosur por edhe paramasën po ashtu të nënshkruar dhe të vulosur. Nëse AK ka pasur nevojë për ndonjë sqarim shtesë, ne jemi të hapur të sqarojmë cilëndo pjesë të ofertës tonë sipas nevojave të AK. Megjithatë AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë, prandaj ne së bashku me këtë kërkesë për rishqyrtim kemi bashkangjitur edhe një deklaratë përmes të cilës mund të rikonfirmohet se ne kemi përmbushur edhe këtë kërkesë të dosjes së tenderit ndersa arsyeja e parë për eliminimin tonë është e pabazuar në tërësi. Bashkangjitur me këtë kërkesë për rishqyrtim do të gjeni deklaratën si më sipër por edhe garancionin e prodhuesit, paramasën dhe planin dinamik të dorëzuar me ofertë”*.

**Pretendimi i dytë:** *“Arsyeja e dytë për eliminimin tonë është po ashtu e pabazuar në tërësi pasi që inxhinieri ynë Jasmir Morina ka diplomuar me datë 30 prill 2008 dhe është në marrëdhënie profesionale të punës që nga ajo kohë. Pra ai ka përvojë profesionale të punës jo vetëm 5 vite pas diplomimit sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit por ka përvojë mbi 15 vite. Sa i përket keqkuptimit të krijuar lidhur me diplomën e tij, ju njoftojmë se në vitin 2022 inxh. Jasmir Morina e ka përditësuar diplomën e tij duke e azhurnuar edhe me të dhënat e drejtimit konstruktiv (sepse në vitin 2008 kur ai ka diplomuar nuk ka ekzistuar si i tillë). Sidoqoftë, të bashkangjitur me këtë kërkesë për rishqyrtim do të gjeni jo vetëm diplomën e tij të vitit 2008 dhe diplomën e azhurnuar të vitit 2022 por edhe shtojcën e diplomës të lëshuar nga vet Universiteti i Prishtinës ku sqarohet arsyeja pse diploma e vitit 2008 është dashur të azhurnohet me të dhëna në vitin 2022, duke konfirmuar njëkohësisht se inxh. Morina ka diplomuar në vitin 2008 dhe jo në vitin 2022 sikurse pretendon AK. Prandaj edhe arsyeja e dytë për eliminimin tonë është e pabazuar në tërësi”*.

**Lidhur me pretendimin e parë** duhet sqaruar se ky pretendim ndërlidhet me arsyen e parë të eliminimit sipas njoftimit mbi vendimin që i referohet një gabimi teknik në përshkrimin e çmimit me të cilën ka ofertuar parashtruesi. Ky gabim teknik i referohet rubrikave lidhur me garancionin e prodhuesit, planin dinamik si dhe paramasën e ofertuar nga parashtruesi. Lidhur me këtë fakt parashtruesi ka bashkangjitur me kërkesën e tij për rishqyrtim një deklaratë ku ka sqaruar gabimin teknik të evidentuar por njëkohësisht ka bashkangjitur edhe garancionin e prodhuesit, planin dinamik si dhe paramasën, të gjitha të nënshkruara dhe të vulosura. Pas administrimit të këtyre provave të parashtruesit, është gjetur se pretendimi ankimor është në tërësi i bazuar dhe devijimi i vogël teknik sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar nuk mjafton si arsye e vetme për eliminimin e parashtruesit nga aktiviteti i prokurimit.

Lidhur me pretendimin e dytë i cili i referohet arsyes së dytë eliminim, është gjetur se konstatimi i komisionit vlerësues sipas të cilit inxh. i propozuar nga parashtruesi Jasmir Morina nuk i ka 5 vite përvojë të punës pas diplomimit sipas DT është konstatim i pasaktë. Ky fakt është konfirmuar duke u bazuar në diplomën dhe shtojcën e diplomës së inxhinierit në fjalë të dorëzuar nga parashtruesi me rastin e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parashtruesit është i bazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 20.05.2024**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimin të këtij vendimi.